



## **Përkushtimi i duhur për gratë dhe vajzat që punojnë në industrinë "Fason" në Shqipëri, gjatë pandemisë COVID - 19, nga të gjithë aktorët e përfshirë në shfrytëzimin e punës së tyre gjatë gjithë këtyre viteve**

Përgatitur nga Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" në kuadër të projektit "Sigurimi i kushteve të duhura të punës për gratë punëtore në fabrikat e veshjeve dhe këpucëve në Shqipëri" të mbështetur nga Olof Palme Centre International, përmes mbështetjes financiare të Qeverisë Suedeze. Përmbajtja është përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Qeverisë Suedeze ose të Olof Palme International Centre.

.....

## **Due Diligence for women and girls working in the "Fason" Industry in Albania, during pandemic COVID-19, from all actors involved in exploitation of their work throughout these years**

Prepared by the "Gender Alliance for Development" within the project "Ensuring proper working conditions for working women in clothing and footwear factories in Albania" supported by Olof Palme Center International, through the financial support of the Swedish Government. The contents are the responsibility of the authors and do not necessarily reflect the views of the Swedish Government and/or the Olof Palme International Center.



Për shumë nga 60000 gra e vajza punonjëse në Industrinë e Prodhimit të Veshjeve të Sipërme dhe të Poshtme (konfeksione dhe këpucë) në Shqipëri, të ardhurat e tyre nga qepja e rrobave dhe pjesëve të ndryshme të këpucëve për punëdhënësit e tyre, të cilët e marrin porosinë nga vendet fqinje, kryesisht Italia, për llogari të klientëve të cilët përfshijnë disa nga kompanitë më të mëdha të modës në botë, mund të jenë kritike për mbijetesë dhe mirëqenie, në kushtet e masave të marra për shkak të COVID-19. Në bazë të sondazheve të kryera nga Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", në periudha të ndryshme që kur filloi mbyllja për shkak të masave të marra për të parandaluar përhapjen e COVID-19, shumë prej këtyre grave janë hequr tashmë nga listë pagesat, pra janë pushuar ose larguar vetë nga puna për disa arsye të rëndësishme të renditura më poshtë:

- 1. Kompanitë shqiptare në këtë biznes kanë mbetur me porositë e dhëna në shkurt e fillim marsi dhe nuk e kanë të qartë nëse do të vazhdojnë me po të njëjtat kushte/kontrata apo porosi.**
- 2. Gratë e vajzat që nuk mund të arrijnë vendin e punës pa një mjet transporti e kanë të pamundur të paraqiten në punë.**
- 3. Gratë që kanë fëmijët në shtëpi për shkak të mbylljes së shkollave, kopshteve e çerdheve, gjithashtu e kanë pothuaj të pamundur të punojnë.**

Ministrja e Financave, Anila Denaj parashikon që për një muaj e gjysmë të ketë bllokim të aktiviteteve ekonomike dhe se pritet të humbasin 50-60 mijë vende pune.<sup>(1)</sup> "Ka të bëjë me një impakt të padëshiruar të situatës. Edhe fondi i garancisë sovraane, i cili nuk është i detyruar, por një marrëdhënie kontraktuale mes dy klientëve, biznesit dhe bankës, u ofrua për këtë qëllim, që bizneset të mos largojnë punonjësit nga puna. Por jemi të ndërgjegjshëm, që do të ketë një rritje të numrit të të papunëve që do të arrijë në 50 mijë -60 mijë persona në 1-1,5 muaj"- shprehet znj. Anila Denaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë. Ajo u kërkoi bizneseve që të respektojnë Kodin e Punës e veçanërisht nenin 144. <sup>(2)</sup>

(1) <http://www.gazetadita.al/ministrja-do-humbasin-60-mije-vende-pune-te-tjeret-rroga-minimale/>

(2) Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë. Neni 144. Procedura e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi.

For more than 60.000 women working in the Garment and Footwear Production Industry in Albania, their income from sewing clothes and different parts of shoes for their employers, - who receive orders from neighbouring countries, mainly Italy, from clients that include some of the largest fashion companies in the world, - may be critical for survival, during the measures taken to withstand COVID-19.

On the grounds of surveys undertaken by the "Gender Alliance for Development" Centre, in different periods since the start of closure due to the measures undertaken to prevent the COVID-19 outbreak, many of these women have been removed from salary lists, meaning they have been fired or left their jobs themselves due to relevant reasons as described below:

- 1. Albanian companies operating in this sector are still working on orders made in February and in the beginning of March and they do not have a clear picture of whether they will continue working with the same conditions/contracts or orders.**
- 2. Women who cannot reach their workplaces without means of transport, find it impossible to go to work.**
- 3. Women whose children are at home, due to the closure of schools, kindergartens, and nurseries, also find it almost impossible to work.**

Minister of Finance, Anila Denaj, foresees freezing of economic activity for a month and a half, during which some 50-60 thousand jobs are expected to be closed.<sup>(1)</sup> "This is an unwanted impact of this situation. The sovereign guarantee fund, which is not mandatory, but a contractual agreement between two clients, - business and bank, - was provided for this exact purpose, for businesses not to lay employees off. However, we are aware there will be an increase of the number of unemployed, which will reach 50-60 thousands persons in 1-1,5 months" - Mrs. Anila Denaj, Minister of Finance and Economy stated. She asked businesses to abide by the Labour Code, especially Article 144.<sup>(2)</sup>

(1) <http://www.gazetadita.al/ministrja-do-humbasin-60-mije-vende-pune-te-tjeret-rroga-minimale/>

(2) Labour Code of the Republic of Albania. Article 144. Procedure on working contract resolution by the employer



Ministrja sqaroi më tej se për sektorin që aktualisht është më i prekuri dhe numëron më shumë punonjës, ai fason, qeveria ka menduar të ndërhyjë për të ridimensionuar kontratat. *“Ne sot po diskutojmë që për industrinë fason të bëjmë një shndërrim për kontratën e porosisë, nga për rroba që nuk po kërkohen aktualisht në Itali si pasojë e epidemisë, në prodhim të maskave apo produkteve të tjera që ka nevojë tregu aktualisht si tregu i brendshëm dhe ai i jashtëm. Kjo bëhet për të mbajtur njerëzit në punë, jo me fond page, por me sigurim të punës.”*- tha ministrja e financave.(3)

Pra mendohet që nga kjo krizë e krijuar do të humbasin shumë vende pune, por deri tani nuk ka një projeksion të qartë se 60.000 vendet e punës për të cilat flet ministrja Denaj i takojnë këtij apo atij sektori. Por është e qartë që me anulimin apo pezullimin e porosive të veshjeve dhe këpucëve, mbylljen e njësive apo qendrave tregëtare kudo në botë ky sektor mendohet të futet në vështirësi të papërbalueshme.

Në një letër drejtuar Qeverisë Shqiptare gjatë kësaj periudhe, Shoqata Kombëtare e Punëdhënësve “Proeksport Albania”, e cila përfaqëson dhe mbron interesat ekonomike të kompanive që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e prodhimit të veshjeve dhe këpucëve me material porositësi (Fason) ata deklarojnë:

- Ndodhemi në kushtet e pamundësisë për të vijuar pagesën e pagave të punonjësve, si për ndërmarrjet që punojnë, ashtu edhe për ato që janë në pamundësi të vijmësisë së kontratave. Për të mos u dukur si paradoks, për pjesën e parë të ndërmarrjeve, ju sqarojmë se, edhe pse punojmë në kushtet të vështira, nuk kemi marrë dhe nuk shpresojmë të marrim asnjë pagesë nga kontraktorët, sepse pagesat janë shtyrë në kohë për shkak se tregu nuk siguron shitjen e produkteve tona për arsye të Pandemisë Globale.
- Ndodhemi në kushtet e pamundësisë edhe për të negociuar me bankat tregtare, ngadalësia e të cilave për të aktivizuar shtyrjen e kredive apo aplikimin për kreditë e mbështetura në garancinë sovranë, është e pafalshme.

The minister further explained that the government had thought of intervening to re-purpose the contracts of the so called “Fason” sector, which is the sector that is most affected and which has the largest number of employees. *“We are currently discussing of re-purposing the order contracts of the “fason” industry, i.e. instead of clothes, - which are not currently being sought from Italy, due to the epidemic, - to produce masks or other products that are currently needed in the domestic and foreign market. This is intended at keeping people in their jobs, not through salary funds, but by ensuring work.”*- The Finance Minister said.(3)

So, many people are going to lose their jobs due to the crisis, but there is no clear projection so far to which sector the 60.000 jobs mentioned by Minister Denaj belong to. However, it is clear that the cancellation or suspension of orders for garments and footwear, as well as the closure of trade units and centres all over the world is expected to put this sector in immense difficulty.

“Proeksport Albania” National Employers Association, which represents and defends the economic interests of companies that operate in garments and footwear production through raw material delivered by the employer, said the following in a letter sent recently to the Government of Albania:

- We are unable to continue paying the salaries of employees. This applies to both enterprises that are currently working, as well as those which are unable to continue the contracts. Just to explain this seemingly paradox for the former: even though we work in difficult conditions, we haven’t received and we do not expect to receive payment from contractors, because payments have been postponed in time since the market doesn’t enable the sale of our products due to the Global Pandemic.
- We are also unable to negotiate with commercial banks, which are unforgivably slow to activate the postponement of loans or applications for loans based on sovereign guarantee.



- Ne nuk mund të aplikojmë për kredi, kur nuk njohim asnjë nga kushtet, kur këto nuk i njohin as bankat dhe për më tepër kur deklarohet se normat e interesit të kësaj kredie me garanci bankare fillojnë te pragu 3 për qind e lart. Kjo është e papranueshme dhe jologjike në kushtet në të cilat ndodhemi! Bankat janë biznese si ne, por bankat nuk mund të sigurojnë një normë të tillë fitimi në kushtet e tanishme. Ne kërkojmë ndryshimin e menjëhershëm të kësaj strategjie të bankave tregtare dhe një rol më të ashpër të Bankës së Shqipërisë.
- Ndodhemi në kushtet e pamjaftueshmërisë së likuiditetit duke filluar nga ky moment dhe nuk mund të marrim përsipër pagesën e pagave të punonjësve tanë.
- We cannot apply for loans when we don't know any of the conditions, when even banks don't know them, and when there are statements being made that the interest rates of such loans would start at a 3 percent threshold and above. This is unacceptable and illogical in the current conditions! Banks are businesses, just like us, but banks may not benefit such a profit rate in the current conditions. We demand immediate shift of strategy by commercial banks and also a tougher role of the Bank of Albania.
- We are facing insufficient liquidity right now, and we cannot afford paying salaries to our employees.

Sipas të dhënave të marra nga z. Bardhi Sejdarasi, përfaqësues i Shoqatës së Prodhuesve Eksportues "PROEKSPORT ALBANIA", numri i ndërmarrjeve, sipas deklarimit zyrtar të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është 669 në fund të vitit 2019. Ndërsa, numri i të punësuarëve sipas deklarimit zyrtar është 69 mijë punonjës/e, nga të cilët 91,7 % janë gra dhe vajza, rreth 95 % e të cilave vijnë nga zonat suburbane.

Bazuar në informacionet më sipër është mjaft e qartë se për rreth 70.000 punonjëse të sektorit në Industrinë e Prodhimit të Veshjeve të Sipërme dhe të Poshtme (konfeksione dhe këpucë) në Shqipëri, të ardhurat e tyre do të jenë kritike për të mbijetuar dhe për të patur bukë në tryezat e familjeve të tyre. Kriza ekonomike e shkaktuar nga pandemia COVID-19 ka filluar pasi në bazë të sondazheve tona, shumë gra tashmë kanë mbetur të papuna dhe janë hequr nga listë pagesat e këtyre ndërmarrjeve.

Kjo krizë ka efekte të njëpasnjëshme pasi filloi si pjesë e masave për distancimin shoqëror, e cila solli uljen e kërkesave për rroba të reja pasi njësitë tregëtare janë mbyllur dhe blerësit qëndrojnë në shtëpi, duke ndaluar blerjen e sendeve të luksit dhe gjërave jo thelbësore.

According to data received by Mr. Bardhi Sejdarasi, representative of the Exporting Producers Association "PROEKSPORT ALBANIA", the number of enterprises, according to the official statement of the General Directorate of Taxation, was 669 in the end of 2019. Whereas the number of employees according to the official statement is 69 thousand employees, of whom 91,7 % are women, some 95 % of whom are from suburban areas.

On the grounds of the information above, it is very clear for approximately 70.000 employees in the so called "Fason" Industry in Albania, that their income will be critical for survival and for providing food in their family tables. The economic crisis caused by the COVID-19 pandemic has already started, as our surveys show that many women have already lost their jobs and have been removed by the salary lists of enterprises.

This crisis has a chain effect. It started as part of the social distancing measures, which led to the reduction of demand for new clothes, with closed shops and buyers staying at home, halting the purchase of luxury and non-essential items.



Nga ana tjetër shitësit me pakicë po bëjnë gjithçka munden për të shmangur shtimin e mallit të tyre dhe mbajtjen e stoqeve të pashitura. Nuk ka të dhëna të sakta se sa është dëmi për Shqipërinë nga ndalimi i porosive për këtë sektor. Ndoshta në muajt e ardhshëm do të kemi një përllogaritje të parë nga perspektiva gjinore.

Bazuar në të dhënat e z.Bardhi Sejdarasi, deri në fund të vitit 2019, tekstilet dhe këpucët janë zëri kryesor i eksporteve, me rreth 40% të totalit, sipas Institutit të Statistikave. Gjithashtu, totali i produkteve të shitura jashtë vendit për periudhën janar-dhjetor 2019 ishte rreth 300 miliardë lekë, nga të cilat 118 miliard lekë ishin veshje dhe këpucë, që për këtë sektor do të thotë 4,5 % më pak në bazë vjetore, krahasuar me një vit më parë.

On the other hand, retail vendors are making the most to avoid increasing their stocks, which would not be sold. There are no accurate data on the actual damage caused in Albania due to the stopping of orders for this sector. Maybe we will have a first estimation of the situation, - as seen from the gender perspective, - in the following months.

On the grounds of the data from Mr. Bardhi Sejdarasi, until the end of 2019, textiles and shoes are the main item of exports, comprising approximately 40% of the total, according to the statistics institute. Moreover, the total of products sold abroad during January-December 2019 reached approximately Lek 300 billion, of which Lek 118 billion from garments and footwear. For this sector, these figures mean 4,5 % less compared to the previous year.

## Histori të trishtuara

## Sad Stories

Në mënyrë që të kishim një tablo më të plotë ne pyetëm gratë dhe vajzat punonjëse të këtyre fabrikave dhe ndërtuam 4 histori reale të tyre të cilat I gjeni më poshtë:

**U.P është një 47 vjeçare, banuese në Bathore** e cila punon prej 20 vitesh në sektorin e industrisë tekstile dhe këpucëve. Aktualisht punon në një nga fabrikat e këpucëve në Bathore. U.P është nënë e tre fëmijëve, 2 vajzave adoleshente dhe një djali 9 vjeçar. Bashkëshorti i saj, si shumë burra të tjerë në Shqipëri ka 4 muaj që është larguar në emigracion në kërkim të të ardhurave më të mira për të ndihmuar familjen. Në kushte mjaft të vështira ekonomike, U.P përpiqet e vetme të jetë forca e vetme dhe të plotësojë me sa të mundet kushtet e fëmijëve. Por vallë, sa shumë kushte mund t'i plotësojë një nënë 3 fëmijëve të saj, kur maksimumi që ajo merr në fund të muajit është 23.000 lekë të reja? Dhe kur flasim për kushte, nuk e teprojmë më pritshmëritë e larta. Bëhet fjalë për një stil minimalist jetese, gati në kufi të mbijetesës.

In order to have a clearer picture, we asked the women who work in the said factories and you may find 4 real stories below:

**U.P. is a 47-year-old woman living in Bathore**, who has been working in the textile and shoes industry for 20 years. She currently works in one of the shoe factories in Bathore. U.P. is the mother of three children, 2 teenage daughters and a 9-year boy. Her husband, like many other men in Albania, emigrated 4 months ago for the purpose of better income to maintain the family. In a very difficult economic situation, U.P. tries alone to fulfil as many of the family's needs as possible. However, how much can a mother of 3 fulfil, when the maximal salary she receives is Lek 23.000? Moreover, when we talk about needs, we don't imply high expectations. We are talking about a minimalistic lifestyle, almost in the verge of survival.



Kjo nënë dëshiron të mund t'i paguaj fëmijëve internetin, ku të ndjekin mësimet. Dëshiron që secila nga vajzat të ketë një palë atlete për vete dhe të nxjerrë djalin njëherë tek lodrat. Situata e COVID-19 e ka rënduar edhe më shumë situatën familjare të U.P. Fabrika ku ajo punon, nuk e paguan për ditët të cilat e detyron të qëndrojë në shtëpi si pasojë e pandemisë. Bashkëshorti tashmë mbetet i bllokuar dhe pa punë larg shtëpisë pa asnjë mundësi rikthimi. Muajin prill, kjo nënë dhe tre fëmijët e saj do duhet ta kalojnë me vetëm 15.000 lekë të rinj. Ndërkohë ajo dhe bashkëshorti kanë marrë dikur një kredi 200000 lekë te Banka NOA. Për shkak se punët nuk vajtën siç i kishin menduar ata nuk e shlyen dot kredinë dhe ajo tani është rritur së tepermi nga kamatvonesat. Dosja e kredisë së tyre ka shkuar në përbarim dhe asaj i është komunikuar që do të fillohet të mbahet nga paga e saj.

.....

**Zonja M, 52 vjeç, banuese në Shkodër,** është punonjëse prej vitesh e sektorit të industrisë tekstile dhe këpucëve. Aktualisht punon në një nga fabrikat e veshjeve në Shkodër. Prej 15 vitesh, e mbetur e ve M. mundohet me mish e me shpirt të nxjerrë në jetë sa më parë dy djemtë e saj të mbetur jetim në moshë të vogël. Ata sot janë 18 dhe 15 vjeç. Të dy të dalluar në shkollë, por me sy që nuk qeshin shpesh. Arsyet për këtë? Të shumta! Burimi i të cilave nis tek i vetmi burim të ardhurash që hynë në atë shtëpi. Jo më shumë se 26.000 lekë të rinj që znj. M. mund të sjellë në fund të çdo muaji nga puna që bën. Ushqime, veshmbathje, ujë, drita nuk duhet të jenë luks, por për znj.M. dhe djemtë e saj, janë! I gëzohen dritës, pasi nuk kanë qënë të pakta netët që kanë ndjenjur në errësirë. Situata e COVID-19, ka bërë që për familjen e saj gjërat të vështirësohen edhe më shumë. Qysh prej datës 11 mars ajo nuk punon. Nuk ka asnjë informacion se kur puna do të rifillojë. Marsi për të u mbyll me vetëm dhjetë ditë punë, dhe kjo nënkupton që muajin prill, ajo me dy djemtë e saj do duhet ta kalojnë me vetëm 12.000 lekë të rinj.

This mother wishes she is able to pay for internet for her children, so they can attend online school curricula. She wishes for each daughter to have a pair of sneakers and to send her boy to the playground once. The COVID-19 outbreak made U. P's family situation even more difficult. The factory where she works doesn't pay for the days, she has to stay at home due to the pandemic. Her husband is now stuck far from home and unemployed, lacking the ability to come back. In April, this mother with three children has to make ends meet with only Lek 15.000. Furthermore, she and her husband took a Lek 200.000 loan from NOA Bank in the past. Because things didn't go as expected, they didn't manage to repay the loan and now it has visibly increased due to arrears. Their loan file was sent to the Bailiff's Office and she was told they would start keeping it from her salary.

.....

**Mrs. M, 52 years of age, living in Shkodra.** For years she has been working in the textile and shoes industry. She currently works in one of the clothes factories in Shkodra. Widowed for 15 years, Mrs. M. tries very hard to help her two boys, orphans since a young age, start a life. Currently, they are 18 and 15 years old, respectively. Both of them are very good at school, but their eyes don't often "smile". The reasons for this? Numerous! The origin of such reasons is having only one source of income for the household. Not more than Lek 26.000 brought home by Mrs. M. at the end of each month. Food, clothes, water, and electricity shouldn't be a luxury, but they are such for Mrs. M. and her boys! They are happy about the electricity, since there have been many nights when they stayed in the dark. The COVID-19 outbreak made things even more difficult for her family. Since the 11th of March, she doesn't work. She doesn't know when work will restart. She only worked ten days in March and this means she and her kids have to live through April only with Lek 12.000 in total.



**D, 29 vjeç, banuese në Durrës**, punon prej 8 vitesh në sektorin e tekstileve. Aktualisht ajo punon në një prej fabrikave që prodhojnë veshje. Me sektorin atë e ka njohur nëna dhe motra e saj më e vogël. Njohja nuk ka qënë nga dëshira, thotë ajo, por nga nevoja dhe pamundësia për një vend më të mirë. D. është paksa ndryshe nga koleget e saj në fabrikë. Ajo ka kryer studimet e larta dhe master profesional në degën Administrim Publik në Universitetin “Aleksandër Moisiu në Durrës”. Ajo vjen nga një familje e madhe prej 6 motrash. Aktualisht në shtëpi jetojnë nëna, babai dhe 4 motrat, të cilët ushqehen me rrogën e saj dhe të babait. Drama e saj është më e madhe, sepse ajo kupton që rroga nuk është i vetmi problem me të cilin ajo ndeshet. Sa herë kthehet nga puna ajo mbart me vete një stres shumë të madh që i atribuohet vetëm punës. Merr me vete të bërtiturat, ulëriturat e nëpërkëmbjen e diskriminimin që gjithqysh e përjetojnë të gjitha gratë që punojnë në atë fabrikë. Sjellja çnjerëzore e drejtuesve, mungesa e respektit dhe solidaritetit atë e mendojnë edhe më shumë.

.....

**B.D. banuese** në qytetin e Kuçovës, punëtore prej vitesh në një nga fabrikat “fason” në Kuçovë. Ajo është nënë e dy vajzave. Zonja ka qënë shpesh pjesëmarrëse në aktivitetet e zhvilluar nga Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” në Kuçovë në lidhje me të drejtat e grave në vendin e punës. Ajo e shqetësuar gjithmon ka ngritur zërin përsas i përket kushteve të punës apo pagesës mjaft të vogël, duke qënë se ajo paguhet vetëm me 100 lekë ora. Të ardhurat familjare janë goxha të ulëta për familjen e tyre. Bashkëshorti i saj është invalid në karrige me rrota. Pagesa mujore që ai merr si i tillë nuk mjafton as për të blerë ilaçet për të cilat ai ka nevojë. Goditja e paparishkuar nga COVID-19, ka bërë që fabrika ku ajo punon të qëndrojë e mbyllur deri në një urdhër të dytë. Për muajin mars ajo nuk pret më shumë sesa 12.000 lekë pagesë e barazvlefshme vetëm për 11 ditë pune në mars, ndërkohë që për dy javët e mbetura të marsit dhe prillit pretendohet se fabrika do të qëndrojë mbyllur dhe askush nuk do të paguhet.

**Ms. D, 29 years of age, living in Durrës**, has been working for 8 years in the textile sector. She currently works in one of the clothes manufacturing factories. Her mother and younger sister introduced her to this sector. It wasn't out of desire, - she says, - but out of necessity and inability to find a better job. D. is in a slightly different situation compared to her peers in the factory. She has pursued higher education studies in “Aleksandër Moisiu” University in Durrës and has a professional master's degree in Public Administration. She comes from a large family with 6 sisters. Currently, she lives with her mother, father, and 4 sisters, who feed themselves through her salary and the father's salary. Her drama is even bigger, because she realises the salary is not the only problem. Every time she comes back from work, she carries immense stress in her shoulders, which stems only from work. She is subjected to the shouting, screaming, contempt, and discrimination that all women working in that factory go through. The inhumane behaviour of the managers, the lack of respect and solidarity bother her even more.

.....

**B.D. lives in Kuçova** and has been working for many years in one of the clothes manufacturing factories there. She is the mother of two daughters. This lady has often participated in events organised by the “Gender Alliance for Development” Centre in Kuçova, which were related to rights of women in the workplace. She has always raised her voice with concern regarding the working conditions and the very low salaries, as she receives only Lek 100 per hour. Her family income is very low. Her husband is disabled and has to use a wheelchair. The monthly disability payment he receives doesn't even suffice for the medicine he needs. This unpredicted blow from COVID-19 made the factory where she works be closed until a second order. For March, she doesn't expect to receive more than Lek 12.000, which is equal to 11 days of work. In the meantime, the factory is expected to be kept closed for the remaining two weeks of march as well as for April, and nobody will be paid.



## **Raporte nga gra që punojnë në fabrikat e rrobave dhe këpucëve nëpër Shqipëri Informacioni që nga 7 Prilli i vitit 2020**

## **Reports from women working in garments and footwear factories throughout Albania Information as of April 7, 2020**

Puna tek fabrika e këpucëve “Remal”, me vendndodhje në Bathore, që pas mbylljes që bëri më datë 11 mars si pasojë e situatës së emergjencës ka rifilluar punë më datë 16 mars. Ajo që vihet re në këtë fabrikë është se pas rifillimit puna nuk po funksionon si normalisht. Në një javë, ato po punojnë vetëm 4 ditë, nga ora 7.00 deri në orën 13.00. Arsyeja e këtyre pushimeve, sipas eprorëve, bëhet për ti ruajtur nga pandemia. Shqetësuese është se këto ditë pushimi nuk paguhen. Gratë paguhen me 130 lek ora. Pra me një llogari të thjeshtë, në një ditë të këtyre ditëve, gratë e kësaj ndërrmarrje do të marrin 650 lekë/ditë, shumë e cila në krahasim me hallet që këto gra kanë dhe çmimet është e jashtëzakonisht e vogël. Ka gra që janë kryefamiljare apo i kanë bashkëshortët në emigracion, kanë shtëpi me qera e fëmijë për të ushqyer. Aktualisht numri i grave në ndërrmarrje është reduktuar, nga 300 punonjëse në rreth 180. Shumë gra nuk mund të vijnë në punë pasi shtëpinë e kanë mjaft larg dhe kompania nuk u ka siguruar transport. Grave që nuk janë rikthyer në punë, u është komunikuar se i është prerë siguracioni për ndoshta rilidhur sërish në prill. Gjithashtu u është komunikuar që kur të rikthehen në punë ato do të paguhen me minimumin e orës, njëjloj si të ishin fillestare, dhe pse mund të kenë vite experiencë. Pagesa nga 130 lek për orë tyre do u zbresë në 95 lek për orë. Një tjetër problem është se në këtë fabrikë janë rreth 6 gra të moshës 54-58 të cilat kanë 10-15 vite punë në këtë fabrikë. Zonjat në fjalë janë në prag pensioni, qoftë dhe të parakohëshëm, dhe me justifikimin që këto të fundit janë të mëdha në moshë, nuk duan të rrezikojnë t’i marrin në punë nga frika se mos infektohen nga COVID-19, ndaj atyre u është komunikuar pushimi nga puna me telefon. .

“Remal” shoe factory, located in Bathore, since its closure on March 11th in the wake of the emergency situation, has resumed work on March 16th. What is noticed at this factory is that after resuming work is not functioning as normal. In a week, they are only working 4 days, between 7: 00 and 13.00. The reason for this reduction, according to the managers, is to protect them from the pandemic. The problem is that the days off will not be paid. Women are paid 130 lek per hour. So, a simple calculation shows that on a day of these days, the women of this company will receive 650 leke, which compared to the problems these women face and current prices is extremely low. Some of these women are single mothers, or have husbands who are in migration, so they have to rent to pay and children to feed. Currently, the number of women in the company has been reduced, from 300 employees to about 180. Many women can not come to work, because their house is far enough and the company has not provided them transport. Women who have not returned to work, are told that they will not be paid any insurance, until maybe in April. They have also been told that when they get back to work they will be paid a minimum per hour, as if they were beginners, even though they might have years of experience. Payment of 130 lek per hour will drop to 95 leke per hour. Another problem is that there are about 6 women, aged 54-58, who have 10-15 years of experience in this factory. These ladies in question are close to their retirement, some to an early retirement, with the excuse that they are older. They don't want to risk taking them to work for fear of being infected by COVID-19, so they've been told by phone that they are dismissed.





Gjatë kësaj kohe në fabrikë masat e vendosura nga qeveria po zbatohen. Gratë janë të pajisuara me maska, doreza e dizinfektant. Tavolinat gjithashtu janë të larguara një meter nga njëra-tjetra. "REMAL" punon ekskluzivisht vetëm me Italinë, dhe nga porositesit gjatë kësaj periudhe nuk ka ardhur asnjë dërgesë/porosi. Puna vijon me porosinë që ka ardhur që në shkurt.

During this time, measures imposed by the Government are being implemented in the factory. Women are equipped with masks, gloves, and disinfectant. Desks are also placed at a distance of one meter from each other. "REMAL" works exclusively with Italy, but no orders have come during this period from any of its clients. Work continues with orders already received in February.

.....

**Fabrika "Rosalaba" në Durrës**, e ndaloi aktivitetin e saj për 10 ditë, për të rifilluar më pas me datë 23 mars 2020. Orari i punës ka vijuar të jetë i njëjtë 8 orë. Janë shpërndarë maskat dhe doreza, dhe pse maskat nuk u ndërrohen përditë. Transporti sigurohet nga firma. Pjesa më e madhe e grave janë në punë, me përjashtim të atyre që kanë fëmijë të vegjël e nuk kanë ku ti lënë. Atyre u është thënë që vendi i punës do t'ju ruhet, por tani që nuk punojnë nuk do të marrin asnjë pagesë. Kishin kërkuar informacion tek përgjegjësia, por ajo u kish thënë se nuk kishte informacion të saktë se si do të procedohet me pagesat. Porosi tjetër nga Italia nuk ka pasur, ndaj puna vijon me porosinë e ardhur më herët, që ishte e madhe në sasi.

.....

**"Rosalaba" factory in Durres** interrupted its activity for 10 days to resume later on March 23rd 2020. The working hours continued to be the same, i.e. 8 hours. Masks and gloves are distributed, even though masks are not changed daily. Transport is provided by the company. Most of these women are working, except those who have little children and have nowhere to leave them. They are told they will have their jobs preserved, but now that they do not work they will receive no payment. They had asked their boss for information, but she had told them there was no precise information on how to proceed with payments. There have been no new orders from Italy, so they continue to work for an earlier order, was was a large quantity.

.....

**Fabrika "Lovers Albania", në Durrës** e ndaloi aktivitetin e saj nga data 12 deri me 23 mars 2020. Javën e parë të rikthimit në punë, gratë kanë punuar me orar të reduktuar, nga ora 7.00 deri në orën 13.00. Më pas puna ka vijuar me orar të plotë, 7.30-16.00. Përsa i përket pagesës në lidhje me ditët e pushimit grave u është thënë që do paguhen, por ato ende nuk janë të qeta, pasi këtë gjë ua kanë komunikuar në telefon, ndërkohë që kur u kthyen në punë, ekonomistja u ka thënë se ende nuk ka marrë ndonjë urdhër, ndaj atyre u mbetet të presin deri me datë 10 prill që marrin pagën për të kuptuar vërtetë nëse janë paguar ose jo.

.....

**"Lovers Albania" factory in Durres** interrupted its activity from 12 March to 23 March 2020. The first week of return to work, women have been working on a reduced schedule from 7: 00 to 13.00. Then, they continued to work for the normal full working hours, 7: 30-16.00. With regards to the payment for the days off, women were told that they would be paid, but they are not still clear, because this is what they were told on the phone, while back at work, the finance officer said she had not yet received any order, so they will have to wait until the 10th of April, which is when they are expected to get their normal salary, to see whether they are paid or not.



Aktualisht aty mungojnë rreth 15 gra cilat nuk mund të vijnë pasi kanë fëmijët vetëm në shtëpi, dhe u është komunikuar që nuk do të paguhen. Ndërkohë që pjesa tjetër që janë në punë do paguhen si normalisht. Tavolinat janë një metër të larguara nga njëra tjetra, dhe u janë dhënë maska të cilat nuk janë ndërruar qysh prej dy javësh. Disa gra, nga frika dhe rreziku shumë i lartë që ekziston mbi virusin, përpiqen të krijojnë mundësinë vetë për ti qepur me napa, por jo të gjitha mund ta bëjnë këtë. Porosi e re nga Italia nuk ka ardhur dhe puna vijon me porosinë ekszituese.

.....

**Puna në "Moda Jeans", Shkodër** vijon të mbetet e ndërprerë. Kjo është një kompani me rreth 150 punëtorë. Pas komunikimit që kanë pasur me pronarin, ai u ka bërë të ditur që fabrika nuk do të hapet deri në momentin që do të kalojë faza e rrezikut. Për muajin mars 2020, gratë kanë punuar vetëm 10 ditë me 1200 lekë dita, gjë që nënkupton që më datë 7 prill ato do të paguhen me vetëm 12000 lekë. Një problem i shtuar në listën e problemeve të tyre, sepse siç ndodh rëndom, gratë që punojnë në fabrika tekstilësh apo këpucësh, janë ato që kanë më pak mundësi të tjera punësimi dhe ato që pagën e kanë jetësore në kuptimin e parë të fjalës. Pronari ka premtuar që për muajin prill do ti paguaj në total vetëm 2 javët e para edhe pse nuk do punojnë. Nga situata e përshkruar puna në këtë fabrikë funksionon sipas rregullave. Të gjithë janë të pajisur me kontrata individuale të cilat i kanë dhe në shtëpi si kopje, ditën e punës e kanë të paguar me 1200 lekë. Sipas komunikimit, puna e tyre ka stopuar tek dërgesa/porosia e fundit që kishte ardhur në fillim të shkurtit nga Italia, e cila pret të përfundohet me rihapjen e aktivitetit.

.....

**Fabrika "Miri" në Elbasan**, e ka ndërprerë punën qysh me datën 11. Grave nuk ju është komunikuar se në çfarë date do të rifillojë puna. Grave ju është thënë se do paguhen vetëm për 10 ditë punë të marsit, ndërkohë që për pjesën tjetër ato nuk do paguhen.

Currently, there are about 15 women who can't come to work, because they have children alone at home, and they were already told that they won't get paid. In the meantime, the rest, who are now working, will be paid as usual. Desks are placed at a distance of one meter away from each other, and they have been provided with masks, which were not changed since two weeks. Some women, from fear and risk of infection from the virus, try to sew their own masks, using cotton fabric, but not all of them can do that. There have been no new orders from Italy, and work continues on previous orders.

.....

The work on **"Moda Jeans", Shkodra**, is still interrupted. This is a company of about 150 workers. After communication they had with their owner, he let them know that the factory will not open until the risk phase passes. For March 2020, women have only worked 10 days with 1200 leke a day, which means on April 7th they will be paid only 12,000 leke. This is one more problem to their problem list. Usually, women working in textile or shoe factories are those who have fewer employment opportunities. Salary for them is a matter of survival. The owner has promised them that he will pay them in total only the first 2 weeks, even though they will not work. Work in this factory seems to continue and adhere by the rules imposed. All are equipped with individual contracts, a copy of which they have at home, and they are paid 1200 leke per working day. According to the communication, their work has stopped on the last order that came in early February from Italy, which is expected to be completed with the reopening of the activity.

.....

**"Miri" factory in Elbasan** has stopped working since the 11th. Women have not been told what date work will resume. Women have been told they will only be paid for 10 days of work in March, while the rest of them are not paid.



Në fabrikën **“Mali” në Lezhë**, puna është pezulluar që në 11 Mars 2020 dhe vijon të jetë e pezulluar. Grave u është komunikuar se do të rifillojnë punën atëherë kur të japë urdhër qeveria. Pronari i firmës i ka lajmëruar që për muajin mars, ato do të paguhen vetëm për 11 ditë. Në të njëjtën kohë u ka ndërprerë edhe sigurimet, për t’ua rilidhur sërish kur puna të rifillojë. Ai ka shpejguar se porositë nga Italia janë bllokuar dhe kjo i krijon problem të gjithëve. Krahas pagesës tejet të ulët të këtij muaji, gratë kanë dhe frikën se mos kjo situatë do të sjellë shkurtime në vendin e punës dhe pasiguri.

.....

Në fabrikën **“Melgushi”, në Lezhë**, puna ka stopuar nga data 26 mars për të rifilluar me datë 1 prill. Aktualisht në punë mungojnë vetëm 10 punëtoresh, të cilat kanë frikë dhe nuk duan të shkojnë në punë. Pjesa tjetër, prej 50 punëtoresh vijon punën me orar të shkurtuar 6.30-13.00. Pagesë për ditët që kanë qëndruar në shtëpi nuk do të marrin. Përsa i përket grave që qëndrojnë në shtëpi, vend i punës do t’u mbahet, ndërkohë që siguracioni dhe pagesa u është ndërprerë. Porosi të re nga Italia fabrika nuk ka marrë, puna vijon me dërgesën e fundit që kanë marrë në datë 1 mars, dërgesë të cilën duhet ta dorëzojnë në qershor. Gratë që janë aktualisht në punë paguhen mbi bazë të normës, ku një orë pune paguhet me 110 lekë. Masat mbrojtëse të vendosura nga qeveria, zbatohen plotësisht. Maska, doreza, dizinfektant si edhe largësia e kërkuar respektohet.

.....

Në fabrikën **“Intex”, Kuçovë**, puna ka rifilluar me orar të shkurtër. Gratë nisen për punë në orën 5.30 të mëngjesit për të mbaruar në 12.30 të drekës. Masat e sigurisë së vendosura nga Qeveria po zbatohen, më përjashtim të mungesës së tavolinave larg nga njëra-tjetra, duke qënë se vetë procesi i punës e kërkon një pozicionim të tillë gratë nuk mund të rrinë larg njëra-tjetrës. Nevoja për transport aty nuk ndihet, duke qënë se Kuçova është një qytet mjaft i vogël e të gjithë mund të shkojnë e të vijnë në këmbë.

In **“Mali” factory in Lezha**, work has been suspended since 11 March 2020 and continues to be suspended. Women have been told that they will resume their work when the government gives them the order. The company owner has announced that for March, they will only be paid for 11 days. At the same time, he stopped paying them social insurance, and will start doing that work resumes. He has explained that orders from Italy have been blocked and that creates problems for everyone. In addition to this month's extremely low payment, women fear that this situation will bring layoffs and uncertainty.

.....

At the **“Melgushi” factory in Lezha**, work has been stopped from March 26th to resume on April 1st. Currently there are only 10 workers not working. They are afraid and do not want to go to work. The rest, 50 workers, continue to work from 6.30 to 13.00. They will not be paid for the days they've stayed at home. As for women staying at home, the job will be kept, while insurance and payments have been cut off. No new orders from Italy received, work continues for the last order they received on March 1st, delivery, which will have to have ready in June. Women, who are currently working, are paid on a rate, where a working hour is paid at 110 leke. Protection measure imposed by the government are fully implemented. Masks, gloves, disinfectant, as well as the required distance is respected.

.....

**“Intex” factory in Kucove** has resumed work for reduced hours. Women leave for work at 5: 30 in the morning and finish at 12.30 p.m. Security measures imposed by the government are being implemented, except for the distance between desks. The process is such that women can not be far from each other. There is no need for transport there, as Kucova is a very small town and everyone can go on foot.



Në dijeninë e grave punëtore nuk ka porosi të re nga porositësit Italianë. Përsa i përket pagesave gratë e kanë marrë pagën në varësi të orëve që kanë punuar. Gjithashu pagesa ju është bërë në rregull. Fabrika punon me numrin e plotë të punonjëseve, pa shkurtime.

.....

**Fabrika "Ediana", në Kuçovë**, në datën 11 mars 2020, janë shkëputur nga puna dhe janë rikthyer më datë më 30 mars 2020. Orari që ato kanë është 07:00 me 3:00. Dy javët që kanë qënë pushim pagesa nuk iu është bërë. Ato kanë shkuar tek punëdhënësi dhe i kanë kërkuar shpjegim mbi këtë fakt, por ai i është përgjigjur se për shkak të situatës e ka të pamundur vijimësinë me pagesa të plota, duke qënë se dhe porositë nga Italia janë stopuar. Kjo ka vënë në krizë të gjithë fabrikën. Deri tani po punohet me numër të reduktuar. Gratë që e kanë shtëpinë afër, vijnë në punë, pjesa tjetër që ka nevojë për transport, të cilin kompania nuk e mundëson, qëndrojnë në shtëpi dhe nuk paguhen. Gratë aty paguhen me 100 lekë ora. Për marsin ato numërojnë vetëm 11 ditë pune.

.....

**Në fabrikën "Vittorini" në Elbasan**, puna ka rinisur më datë 1 prill, pas ndërprerjes në 11 Mars 2020. Orari vijon të jetë ai i përhershmi, 7.30 me 16.00. Tani për tani punojnë vetëm 50 gra nga 85 që kanë qënë. Puna aty me parë, ndahej në dy manovi, ndër kohë që tani funksionale është vetëm një manovi. Pjesa e grave që punojnë në manovinë e dytë, (që është një process pak më i thjeshtë pune që mund ta mbulojnë gratë e manovisë së parë), janë lënë në shtëpi deri në zgjidhje të situates së COVID-19. Gratë janë mjaft të shqetësuara duke qënë se qëndrime të tilla të detyruara në shtëpi, nuk janë të paguara. Gratë që momentalisht punojnë, dhe që në mars mbyllën vetëm 10 ditë pune, ju është komunikuar se nuk do të paguhen për ditët që nuk punuan. Porosi të reja nga Italia nuk ka pasur. Puna vijon me ritme më të ulta mbi porosinë e ardhur më herët. Përsa i përket masave të sigurisë, gratë kanë maska të cilat i kanë blerë ose qepur vetë, të cilat dhe i lajnë, ndërkohë që doreza nuk mbahen duke qënë se janë të detyruara të bëjnë tegela, qepje në makinë dhe mbajtja e tyre vështirëson kryerjen e procesit.

As far as women know, there are no new orders from Italian clients. As for payment, women received salary depending on the hours they worked. Payment is done correctly. The factory works with its full number of employees, without cuts.

.....

**"Ediana" factory, in Kucove**, stopped working on March 11th, 2020, and resumed work on March 30th, 2020. Their working hours are from 07: 00 to 3:00. They are not paid for the the two weeks off. They have gone to their employer and asked him for an explanation, but he responded that it is impossible for him to continue paying them their full salary due to the situation, and that there have been no new orders from Italy. This has put the entire factory in a crisis situation. So far, it's working on reduced working hours. The women who live near the factory do go to work, while those who live far and need transport, don't, as the company does not provide them with transport. Women there are paid 100 like an hour. For March, they only worked 11 working days.

.....

**At "Vittorini" factory in Elbasan**, work has resumed on April 1st, following a break on March 11th 2020. The schedule follows to be the same, 7: 30 to 16.00. Right now, only 50 women from 85 are working. Work there was divided into two sections, while now one one of them is operational. The share of women working on the second section, (which is a slightly simpler work process that women of the first section can handle), have been left at home until a solution is found to COVID-19 situation. Women are very concerned, since staying at home is not paid. Women who are currently working, and who only worked for 10 days in March, are told they won't be paid for the days they haven't worked. There have been no new orders from Italy. Work continues at lower pace for an order they had already. As for security measures, women have masks that they have bought or sewed themselves. They wash them. They do not wear gloves though, as they have to sew, and wearing gloves makes that process difficult.



## Konkluzione

Situata e krijuar nga COVID-19 ka vënë në vështirësi të mëdha Industrinë e Prodhimit të Veshjeve të Sipërme dhe të Poshtme (konfeksione dhe këpucë) në Shqipëri. Gratë dhe vajzat punëtore që përbëjnë rreth 90 % të të punësuarve në këtë industri rrezikojnë vendin e punës për shkak të mungesës së transportit për të shkuar në punë, mbylljes së shkollave, kopshteve e çerdheve dhe frikës nga infektimi.

Nga ana tjetër puna e tyre rrezikohet nga mundësia e kompanive për të patur kontrata të reja me porositesit të cilët janë kryesisht Italianë, duke marrë parasysh mbylljen e kompanive të ngjashme në të gjithë botën.

Mbyllja në gjithë botën e njësive dhe qendrave tregëtare ku tregëtohen mallrat që prodhohen nga ky sektor gjithashtu rrezikon që gratë e vajzat e punësuar të mbeten pa punë e rrjedhimisht familjet e tyre të hyjnë me shpejtësi në vorbullën e varfërisë. Nuk ka studime fare në lidhje me përfshirjen në kredi financiare të punonjëseve të këtij sektori, por është e qartë se ato që janë përfshirë në kredi bankare, kanë një barrë tjetër të madhe mbi kurrizin e brishtë të tyre, me pasoja të rënda financiare e mirëqenie në familjet e tyre.

Në shumë fabrika ku prodhimi vazhdon, e drejta e punëtoreve për kushte të sigurta pune nuk garantohet. Nga dëshmitë e tyre është e qartë që masat paraprake të sigurisë që ndalojnë përhapjen e koronavirusit nuk janë zbatuar. Sidomos në sektorin e veshjeve ku procesi është i tillë që një pjesë rrobe kalon nëpër shumë duar, është e domosdoshme që të merren masa për mbrojtëset e duhura.

Përgjigja e markave dhe porositesve kryesisht nga Italia në kohën e COVID-19 është anulimi i porositëve. Kjo nënkupton humbje të konsiderueshme në punë pa paralajmërim dhe / ose pagesa të pakta për shkak të pamundësisë për të paguar.

## Conclusions

The situation created by COVID-19 has led to major difficulties for the upper and lower clothing production industry (confections and shoes) in Albania. Women workers, who make up about 90 % of the employees in the industry, risk their jobs due to lack of transportation to go to work, closed schools, nurseries and kindergartens, and fear of infection.

On the other hand, their work is jeopardized by the risk of companies not to have any new contracts with their clients, who are mostly Italian, taking into account the closure of similar companies worldwide.

The closure worldwide of entities and trade centres where goods produced by this sector are traded might also lead to women and girls working in this sector losing their jobs and their families quickly ending up in poverty. There are no studies at all about workers in this sector having taken loans, but it is clear that those involved in bank loans have another major burden on their fragile back, with serious financial consequences on their families.

In many factories, where production continues, the right of workers to safe working conditions is not guaranteed. From their testimonies, it is clear that preliminary security measures preventing the spread of the coronavirus have not been implemented. Especially in the clothing sector, where the process is such that a part of the clothes goes through many hands, it is necessary to take protection measures.

The response of brands and clients mainly from Italy at the time of COVID-19 is the cancellation of their orders. That means a considerable loss of work without warning and/or poor payment due to the impossibility to pay.



Humbja e të ardhurave minimale, mos funksionimi i sistemeve mbrojtëse rrezikon rëndë aftësinë e punëtorëve të veshjeve e këpucëve të sigurojnë veten dhe familjet e tyre me ushqim adekuat dhe të paguajnë për strehim, energji elektrike, ujë apo tjetër.

Kjo çon në një shkelje të të drejtave të njeriut për për ushqim dhe strehim. Ndërkohë ka filluar zbatimi i planit të emergjencës së Qeverisë Shqiptare, ose i ashtuquajturit plani A, por ky plan nuk e përfshin këtë sektor. Shoqata Kombëtare e Punëdhënësve "Proeksport Albania", e cila përfaqëson dhe mbron interesat ekonomike të kompanive që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e prodhimit të veshjeve dhe këpucëve me material porositësi (Fason) i ka dërguar një letër me shpjegime dhe kërkesa Qeverisë Shqiptare për të përballuar pagat e punonjëseve dhe problematika të tjera që dalin nga kërkesa për distancim social për shkak të pandemisë COVID-19.

Losing minimum income, failing to operate protection systems seriously jeopardises the ability of clothing and shoe workers to provide themselves and their families with adequate food and pay for housing, electricity, water or any other supplies.

This leads to a violation of human rights to food and shelter. Implementation of the Albanian government's emergency plan, has in the meantime started, or the so-called Plan A, but that plan does not include this sector. The National Association of Employers "Proeksport Albania", which represents and protects the economic interests of the companies to perform their activities in the field of the production of clothing and footwear materials buyer (façon) has sent a letter to the Albanian Government, with an explanation and a request, regarding paying the salaries of their workers, and the issues arising from the need for social distancing due to COVID-19 pandemic.

## Rekomandime

Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" po vëzhgon situatën e rëndë të krijuar dhe kërkon nga Qeveria Shqiptare:

1. Krijimin e mundësisë që gratë punonjëse të sektorit "Fason" të futen në paketën financiare dhe të marrin të paktën pagesën minimale për 3 muaj. Kjo do të krijonte mundësi që ato të mos largohen nga listë pagesat dhe të mos kenë ndërpreje të pagesës së sigurimeve shoqërore.

2. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat ekonomike, Sociale dhe Kulturore është një nga konventat më të ratifikuara të të drejtave të njeriut në botë, e ratifikuar edhe nga Shqipëria në vitin 1991. Në situatën aktuale, është mjaft e rëndësishme të përcaktohet se cilat janë të drejtave sociale dhe ekonomike që duhet të gëzojnë këto punëtorë dhe cilët janë aktorët përgjegjës për mbrojtjen dhe respektimin e tyre.

## Recommendations

The Gender Alliance for Development Centre is monitoring the severe situation created, demanding the Albanian Government to:

1. Enable women working for the façon sector to be part of the financial package and receive at least minimum payment for 3 months. This would create opportunities for them not to be off the payroll and have no social insurance payment cuts.

2. The International Convention for Economic, Social and Cultural Rights is one of the most ratified human rights conventions, ratified also by Albania in 1991. In the current situation, it is very important to determine what social and economic rights these workers should enjoy, and who are the actors responsible for to protect and respect them.



### Kjo Konventë garanton: (4)

- Të drejtën për sigurime shoqërore (*Neni 9*)
- Të drejtën për standard adekuat të jetesës (*Neni 11*) që përfshin të drejtën për ushqim e shtëpi.
- Të drejtën për të shijuar/patur standardin më të lartë të shëndetit mendor e fizik (*Neni 12*).

3. I bëjmë thirrje ambasadave përkatëse të vendeve shtetasit e të cilëve bëjnë biznes në Shqipëri të mbajnë të përgjegjshëm grupin e këtyre sipërmarrësve/eve që të respektojnë kontratat dhe të sigurohen që bashkëpunëtori i tyre vendas respekton Kodin e Punës dhe të drejtat e njeriut, për punonjëset e "fasonerive".

4. Markat dhe porositësit të cilët shfrytëzojnë krahun e punës në Shqipëri për shkak të nivelit të pagës minimale, ndër më të ultat në Ballkanin Perëndimor, dështuan ti mbrojnë punonjëset e tyre shqiptare dhe kompanitë prodhuese shqiptare nga kjo situatë e papritur.

Por mos harrojmë që këto kompani të huaja që nuk iu kanë paguar këtyre punonjëseve minimumin jetik, por vetëm pagën minimale kanë patur fitime marramendëse. Për këto kompani shteti shqiptar shpresojmë të ketë të dhëna të sakta se cilat janë markat porositëse dhe tu kërkojë atyre të mbajnë përgjegjësi.

Sepse këta të fundit, bazuar në Parimet Udhëzuese të Kombeve të Bashkuara për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut (UNGP), (5) Udhëzimet e OECD për ndërmarrjet, biznesin dhe të drejtat e njeriut, (6) dhe Deklaratës Tre palëshe e ILOs për Kompanitë Multinacionale, (7) kanë përgjegjësi për punëtorët që punojnë për ta kudo në botë.

Në bazë të këtyre dokumentave shumë të rëndësishëm këto kompani dhe marka kanë përgjegjësi të respektojnë të drejtat e njeriut dhe të gjejnë mundësi të zbusin apo korrigojnë dëmin e shkaktuar.

### This convention guarantees: (4)

- The right to Social Insurance (*Article 9*)
- The right to an adequate standard of living (*Article 11*), which includes the right to food and home.
- The right to enjoy/having the highest standard of mental and physical health (*Article 12*).

3. We call on the respective embassies of the countries whose citizens do business in Albania to hold the group of these entrepreneurs accountable in order to respect the contracts and to ensure that their local partner respects the Albanian Labor Code and human rights of workers of the "fason" industry.

4. Brands and clients who exploit the working force in Albania taking advantage of minimum wages applicable here, among the lowest in the Western Balkans, failed to protect their Albanian workers and Albanian production companies from this unexpected situation.

But let's not forget that these foreign companies that didn't pay these employees the minimum living standard, but just the minimum wage, have had huge profits. We hope that the Albanian state has precise data on which these brands are and ask them to take their responsibility.

Because the latter, based on the United Nations Guiding Principles for Business and Human Rights (UNGP ),(5) OECD Guidelines for companies, business and human rights,(6) and ILO's tripartite statements on multinational companies,(7) have responsibilities for workers working for them anywhere in the world.

On the basis of these very important documents, these companies and brands have responsibilities to respect human rights and find opportunities to ease or correct the damage caused.

(4) <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cescr.aspx>

(5) <https://www.business-humanrights.org/en/un-guiding-principles>

(6) <https://www.oecd.org/corporate/mne/>

(7) [https://www.ilo.org/ecomsp5/groups/public/--ed\\_emp/--emp\\_ent/--multi/documents/publication/wcms\\_094386.pdf](https://www.ilo.org/ecomsp5/groups/public/--ed_emp/--emp_ent/--multi/documents/publication/wcms_094386.pdf)

(4) <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cescr.aspx>

(5) <https://www.business-humanrights.org/en/un-guiding-principles>

(6) <https://www.oecd.org/corporate/mne/>

(7) [https://www.ilo.org/ecomsp5/groups/public/--ed\\_emp/--emp\\_ent/--multi/documents/publication/wcms\\_094386.pdf](https://www.ilo.org/ecomsp5/groups/public/--ed_emp/--emp_ent/--multi/documents/publication/wcms_094386.pdf)



5. Të përcaktohet numri i saktë i ndërmarrjeve të Industrinë së Prodhimit të Veshjeve të Sipërme dhe të Poshtme (konfeksione dhe këpucë) në Shqipëri si dhe numri i punonjëseve i pa ngatërruar me sektorë të tjerë dhe kjo të bëhet publike. Gjithashtu të dihen pagat mesatare të këtij sektori bazuar në listë pagesat që kompanitë dërgojnë në Drejtoritë e Tatim Taksave.

6. Të gjitha masat që do të merren nga Qeveria e Shqipërisë, si përgjigje gjatë periudhës COVID-19, duhet të informohen nga analiza gjinore dhe duhet të jenë të ndjeshme nga pikëpamja gjinore.

7. Qeveria e Shqipërisë duhet të monitorojë zbatimin e vendimeve të marra për shkak të COVID-19 në nivelin lokal.

8. Shpresojmë që në të ardhmen të dëgjohej zëri i organizatave të shoqërisë civile kur vjen puna te të drejtat e punëtorëve, sidomos në rastin kur ata/ato shfrytëzohen nga kompani të huaja, vetëm se paga minimale është e favorshme. Në këto raste shteti Shqiptar përveçse të gëzohet për vende të reja pune që këto kompani sjellin, duhet të dijë për kë derdhin djersën punëtorët shqiptarë? A shkelen të drejtat e tyre në punë? A u sigurohet atyre mbrojtje në kohë të qeta dhe në kohë fatkeqësish natyrore si rasti i COVID-19?

5. The Government of Albania to starts determine the exact number of enterprises of the Industry of Production of Upper and Lower Clothing (confectionery and shoes) in Albania as well as the number of employees not to be confused with other sectors and to make this public. Also know the average salaries of this sector based on the list of payments that companies send to the Tax Directorates.

6. All the measures that will be taken by the Government of Albania, as a response during COVID-19 period should be informed by gender analysis and must be gender sensitive.

7. Government of Albania must monitor the implementation of the decisions taken due to COVID-19 at the local level.

8. We hope that in the future the voice of civil society organisations will be heard when it comes to workers' rights, especially when they are exploited by foreign companies, just because of the favorable minimum wage. In these cases, in addition to getting enthusiastic about the new jobs these companies bring, the Albanian state should also know who these workers are sweating for? Are their rights being violated at work? Are they provided with protection both in quiet times and in times of natural disasters like COVID-19 case?

.....

.....

*Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim" (GADC) është një organizatë feministe, jofitimprurëse e vepron në të gjithë Shqipërinë dhe në rajon. GADC është një zë për gratë shqiptare dhe një forcë për ndryshim. GADC punon në të gjithë Shqipërinë, për të fuqizuar gratë dhe për të krijuar një të ardhme me të drejta të barabarta për vajzat dhe gratë me të ardhura të ulëta për të dalë nga varfëria dhe përjashtimi social.*

*The Gender Alliance for Development Centre (GADC) is an Albanian feminist non-profit organization operating all over Albania and in the region. GADC is a voice for Albanian women and a force for change. Our organization works to empower women and to create an equal and just future for low-income girls and women to get out of poverty and exclusion all over Albania.*

**Për më shumë informacion kontaktoni: (For more information contact)**

**Mirela Arqimandriti - Drejtore Ekzekutive (Executive Director)**

**E-mail: [marqimandriti@gadc.org.al](mailto:marqimandriti@gadc.org.al)**

**Tel: 00355682059301**